



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
**Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division**

Prishtine datë, 07.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **28.08.2023**, të parashtruar nga operatori ekonomik **INFINITT SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ritender "Furnizim me inventarë për Njesite Shëndetsore të Burgjeve në DSHB"** me numër prokurimi **206-23-5746-1-2-1**, sot me dt. 07.09.2023 nxjerr:

**V E N D I M**

- 1. Pranohet pjesërisht** kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik INFINITT SH.P.K. e dt. 07.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit Ritender "Furnizim me inventarë për Njesite Shëndetsore të Burgjeve në DSHB" me numër prokurimi 206-23-5746-1-2-1, kundër *Njoftimit mbi Vendimin e AK*, të datës 23.08.2023 të publikuar në platformën elektronike;
- 2. Anullohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i publikuar me datë: 23.08.2023;
- 3.** Autoriteti Kontraktues, e anulon aktivitetin e prokurimit;
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori ekonomik INFINITT SH.P.K. me datë 28.08.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ritender "Furnizim me inventarë për Njesite Shëndetsore të Burgjeve në DSHB" me numër prokurimi 206-23-5746-1-2-1. Autoriteti Kontraktues menjehere është marrë me shqyrtimin e kërkesës në fjalë dhe në bazë të dokumentacionit të lëndës, sot me datën 07.09.2023, vendosi si më poshtë:

**Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:**

*Neni 1 – Qellimi*

*Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti*

*Neni 7 – Barazia në trajtim / jo diskriminimi*

*Neni 28 – Specifikimet teknike*

*Neni 59 – Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve*

*Neni 60 – Kriteret per dhënie te kontrates*

*Neni 65 – Pranueshmeria e Kandidateve ose Tenderuesve*

*Neni 19 i UOPP-se Specifikimet teknike*

*Neni 41 i UOPP-se Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve*

## **Pretendimi ankimor**

AK/Komisioni vlerësues gjate vlerësimit te ofertave për projektin ne fjale nuk ka vepruar ne harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore te lartcekura dhe Udhëzuesin operativ për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me 23.08. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues, LOT 1 eshte anuluar ndersa per LOT2 është rekomanduar për kontrate oferta e dyte, me e shtrenjte se kompania jone Astech sh.p.k.

Kompania jone eshte eliminuar me arsyetimin se produktet e ofruara nuk plotesojne specifikimet teknike per LOT 1 pozicionet 9, 14 ndersa per LOT2 pozicioni 5, citoj arsyejen per eliminim:

### ARSYETIM

Tenderi juaj është i papërgjegjshëm për arsye se:

- Per Lot 1 - Ne katalogun tuaj tek pika 9 specifikat nuk përputhen më kërkesën si ne DT. Eshte kerkuar Karrika menaxheriale ortopedike për zyre lëvizëse/rrotulluese, me mbështetëse , me rrota dhe kualitet të lartë (ulësja dhe mbështetësja mbështjelle me lëkure, konstruksioni metal) ndërsa ju e keni ofruar ndryshe ne katalog.

Artikulli 14 është kërkuar: Ulëse e drurit me mbështetëse 180x50x70 , për ambient të brendshëm në hapësira të pritjes (kombinim ngjyre hiri-krem) pjese e ulëses me mbështjellës te bute material prej shtufi, ndërsa ju në katalog e keni ofruar ndryshe.

- Per Lot 2 - Ne katalogun e ofruar te prodhuesit Ecolux nuk jane me +++A siç jane kërkuar ne dosjen e tenderit, katalogu i ofruar nuk përputhet me web faqen, ku nuk ka klima siç janë kërkuar ne DT me +++A.

Ky konstatim i AK/komisionit vlerësues nuk qëndron, ne vijim do te kundërshtojme cdo pretendim te AK per eliminimin e ofertes sone:

Per poicionin 9 modeli i karriges se ofertuar ploteson kerkesat e autoritetit kontraktues, ulsja dhe mbeshtetsja eshte e mbeshtjellur me lekure si dhe kontruksioni i karriges eshte nga metali, AK nuk ka paraqitur te dhena te detajuara cilen spec.teknike nuk e ploteson prodūkti ne katalog vetem ka thene nuk eshte si ne kerkese. Ne kerkese jane paraqitur specifike teknike te prodūktit dhe jo foto prandaj perderisa nuk ka paraqitur AK skicime apo foto te produktev ne ANEKS 1 te DT nuk mund te qendroje konstatimi i komisionit vleresues se prodūkti ne katalog nuk eshte ofruar si ne kerkese. Ne kemi dorezuar deklarate per specifikime teknike me ane te ciles kemi deklaruar se produktet e ofertuara jane ne perputhje me kerkesat e AK si ne ANEKS 1 te DT.

Poashtu per pozicionin 14 prodūkti i ofertuar ne katalog ploteson te gjitha specifikimet teknike si ne kerkesen e AK ne ANEKS 1 te DT, konstruksioni i ulëses nga druri eshte paraqitur ne foto 1 dhe pjesa e ulëses me mbeshtjelles te bute ne foto 2, poashtu edhe per kete pozicion Vien deklarata e specifikimeve teknike me ane te ciles jemi zotuar se produktet e ofruara plotesojne ne teresi specifikimet teknike si ne kerkesen e AK ne ANEKS 1 te DT.Per LOT 2 oferta e kompanise sone eshte eliminuar me arsyetimin se prodūkti i ofertuar per pozicionin 5. Konditioner nuk ploteson specifikimet teknike si ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit pasiqe modeli i klimes te cilin kemi ofertuar Ecolux CIN140 R32 VENTUM nuk eshte A+++ . Ky konstatim i AK/ komisionit vleresues nuk qendron, ne dosjen e tenderit eshte kerkuar klime me klasin e energjise A++/A+ qe nenkupton A++ ftohje dhe A+ ngrohje e jo siq citon AK ne leter standarde A+++ . Modeli Ecolux CIN140 R32 ka klasin e energjise A+++ prandaj eliminimi nga AK poashtu per ket LOT eshte i padrejte pasiqe kemi ofruar konditioner me te avansuar se kerkesa ne ANEKS 1. Ne anen tjeter AK ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem oferta e te cilit nuk ploteson specifikimet teknike per pozicionin 5. Konditioner-

Kapaciteti i ftohjes eshte kerkuar 3500w ndersa modeli i klimes HOOBART HBTC121NV ka kapacitet 3400w. Poashtu OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem pasiqe nuk ka plotesuar njerren prej kerkesave te pershtatshmerise Doshmia e korkuar dokumentare Korkesa 1 b. Doshmi se operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor saj gjatë dhjetë viteve të kaluarate nuk eshta shpallur fajtoer lëshuar nga Gjykata kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkua ne piken, (a) dhe (b), i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.

OE i rekomanduar per kontrate ka dorezuar certifikate jo-valide me nr 5177/22 te dates 28.06.2022. qe eshte me e vjeter se 12muaj prandaj AK eshte dashur te eliminoje OE ne fjale per mos plotesimin e kerkesave te pershtatshmerise.

OE i rekomanduar per kontrate poashtu eshte i papergjegjshem pasiqe nuk ka plotesuar paramasen sipas kerkeses se AK, ne paramase AK ka kerkuar te pershkruhet Pordhuesi dhe vendi i origjines. OE nuk ka cekur titullin prodhues si dhe vendi i origjines nuk perputhet me produktet per te cilat ka ofruar katalog. OE ka cekur vendin e origjines Turki ndersa produktet Fuego dhe Hoobart kane origjine nga Kina perkatesisht Gjermani.

Mare parasysh faktet e lartecekura konstatojme se AI</komisioni vleresues nuk ka trajtuar te barabarte OE ofertues ne kete aktivitet te prokurimit, kompania jone eshte eliminuar megjithese oferta jone ploteson te gjitha kerkesat e parashtruara nga AK si ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit ndersa ne anen tjeter eshte rekomanduar per kontrate OE i papergjegjshem te Cilit i kemi gjetur nje mori shkeljesh si me larte. Kerkojme qe kerkesa per ri-shqyrtim te aprovohet si e bazuar dhe lenda te kthehet ne rivleresim.

#### Dëmet materiale

Si pasoje e shkeljeve te lartecekura nga AI</komisioni vleresues ka ardhe deri tek eliminimi i kompanise sone pa te drejte dhe dhenia e kontrates per OE te papergjegjshem, ne kete menyre na eshte mohuar fitimi simbolik i paramanduar nga kjo kontrate dhe nuk eshte respektuar neni 60 i LPP-se qe kontrata ti ipet kompanise sone si tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet.

Kerkojme nga zyrtari pergjegjes i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve te aprovoje ankesen (kerkesen per ri-shqyrtim) si te bazuar, lenda te kthehet ne rivleresim ne te kunderten jemi te obliguar te dorezojme anekese ne OSHP.

#### Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore te OE ankues:

##### Për Lot 1

Komisioni i vlerësimit edhe njëherë e ka shqyrtuar lenden dhe ka njoftuar se oferta juaj për Lot 1 artikulli 9 nuk i ka plotësuar kushtet sipas specifikave të kërkuara. Ne jemi bazuar në katalogun/broshurën e ofruar nga ana juaj.

Kërkesa e AK-MSh shkruan: Karrika menaxheriale ortopedike për zyre lëvizëse/rrrotulluese, me mbështetëse , me rrota dhe kualitet të lartë (ulesja dhe mbeshtetsja mbeshtjellur me lekure, konstruksioni metal).

Ndërsa ju e keni paraqitur ndryshe ne katalog/broshure, e keni paraqitur karriken me rrjet dhe jo e mbështjellë me lëkurë siç është kërkuar ne dosje te tenderit.

Për artikullin 14 ne DT është kërkuar: Ulëse e drurit me mbështetëse 180x50x70 , për ambient të brendshëm në hapsira të pritjes (kombinim ngjyre hiri-krem) pjese e uleses me mbeshtjelles te bute material prej shtofi.

Ndërsa ju e keni paraqitur ndryshe. Në broshurën/katalogun e ofruar nga ana juaj shihet se njëra fotografi e derguar shihet pa mbeshtjellese te bute material shtofi dhe tjetra fotografi shihet metal me shtof , jo sic eshte kerkuar ne dosje tenderit.

## Për Lot 2

E kemi shqyrtuar Kërkesën tuaj për Rishqyrtim të datës 28.08.2023 dhe në bazë të sqarimeve të ofruara dhe dokumentacionit të lëndës, pajtohemi me pretendimet e juaja në lidhje me ofertën e OE të rekomanduar "AS Tech" SH.P.K. që është e përgjegjshme, për shkak se pas verifikimit në internet për Artikullin 5 të Lot 2 – Kondicionerit të ofruar HOOBART HBTC12INV-WMSE2, nuk i plotëson të gjitha specifikat teknike të kërkuara në tender.

E kemi shqyrtuar edhe ofertën tuaj, kondicionerët e ofruar nga ana juaj të tipit ECOLUX dhe kemi parë që as kondicionerët e juaj nuk i plotësojnë të gjitha specifikat e kërkuara në tender, si në vijim:

Është kërkuar: Kondicioner inverter (12000 BTU, - e keni ofruar Cooling Capacity(BTU/h) 11600

Është kërkuar: klasa e energjisë A++/A+ - e keni ofruar A+++

Është kërkuar: kapaciteti ftohjes: 3500w - e keni ofruar 3550w

Është kërkuar: kapaciteti i ngrohjes 2600w - e keni ofruar 4250w

Është kërkuar: niveli operativ -15°C deri +50°C - e keni ofruar 18~46°C / -30~24°C

Në bazë të sqarimeve të mësipërme, shfuqizohet Njoftimi mbi Vendimin e AK i publikuar me datën 23.08.2023 dhe aktiviteti **anulohet** për mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

## Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

## Vendimi i dorëzohet:

1. Infinitt SHPK
2. Operatoreve ekonomik të interesuar

  
Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit